



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22.2.2023

Nr: 69

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E MATERIALIT NDIHMËS PËR TRAJNIMIN E KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “gj”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Miratimin e materialit ndihmës për trajnimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i KQZ për kodifikimin e materialit ndihmës për trajnimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

**MATERIAL NDIHMËS PËR TRAJNIMIN E KOMISIONEVE
TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

Përmbajtja

Parimet e përgjithshme të zgjedhjeve	faqe 1
Organet e qeverisjes vendore	faqe 1
Organet dhe administrata zgjedhore për zhvillimin e zgjedhjeve	faqe 1
Çfarë është KZAZ?	faqe 2
Përbërja dhe organizimi i KZAZ	faqe 2
Emërimi i anëtarit dhe sekretarit të KZAZ	faqe 3
Shkarkimi dhe lirimi nga detyra i anëtarit të KZAZ	faqe 3
Vakancat në KZAZ	faqe 4
Mbledhjet e KZAZ	faqe 4
Vendimet e KZAZ	faqe 4
Organizimi i KZAZ	faqe 4
Detyra të KZAZ për krijimin dhe funksionimin e qendrës së votimit	faqe 5
- KZAZ emëron kryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së.	
- Procedura që KZAZ ndjek për të caktuar anëtarin e shtatë	
- KZAZ shkarkon dhe liron nga detyra anëtarin apo sekretarin e KQV	
- KZAZ ndjek procedurat për plotësimin e vakancave në KQV	
Detyra të KZAZ për akreditimin e vëzhguesve	faqe 7
- KZAZ akrediton vëzhgues	
- Procedura për akreditimin e vëzhguesve	
- Verifikimi i dokumentacionit dhe vendimmarrja e KZAZ	
- Të drejta dhe detyra të vëzhguesve	
- Vëzhgues të akredituar nga KQZ. Media e akredituar	
Detyra shtesë për KZAZ që mbulon e vetme territorin e bashkisë.	faqe 9
- Regjistrimi i kandidatit për Kryetar Bashkie i paraqitur nga partia politike/koalicioni	
- Regjistrimi i listës shumëemërore të kandidatëve për anëtar të këshillit bashkiak të propozuar nga partia politike ose koalicioni	
- Regjistrimi i kandidatit për kryetar bashkie i propozuar nga zgjedhësit	
- Regjistrimi i kandidatit për anëtar të këshillit bashkiak të propozuar nga zgjedhësit	
- KZAZ verifikon dokumentacionin e kandidimit.	
Detyra të KZAZ për organizimin e VNV	faqe 12
Detyra të KZAZ për krijimin dhe funksionimin e grupeve të numërimit të votave	faqe 14
- KZAZ emëron me vendim anëtarët e GNV	
- KZAZ garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit	
- Shpërndarja e materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV	
KZAZ merr në dorëzim nga kqy-të materialet e votimit dhe kutitë e votimit	faqe 16



PARIMET E PËRGJITHSHME TË ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor ka parashikuar parime të përgjithshme të zhvillimit të zgjedhjeve. KZAZ, në ushtrimin e detyrave të saj duhet të përmbushë këto parime dhe të veprojë në përputhje me të gjitha parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera të KQZ të dala në zbatim të tij.

Parimet e përgjithshme janë si vijon:

- >> Zgjedhjet janë periodike.
- >> Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin Zgjedhor.
- >> Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës.
- >> Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor.
- >> Subjektet zgjedhore janë të lira të bëjnë paraqitjen e programeve të tyre zgjedhore në çdo formë dhe mënyrë të ligjshme.
- >> Çdo zgjedhës ka të drejtën e vetëm një vote për zgjedhjen e një subjekti zgjedhor.
- >> Komisionet zgjedhore, i përmbushin funksionet e tyre, në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme dhe transparente.

ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Kodi Zgjedhor parashikon se organet e qeverisjes vendore janë:

- >> Kryetari Bashkisë;
- >> Këshilli i Bashkisë.

Këto organe zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë, një herë në katër vjet, nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë.

Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, zgjedhësi voton me dy fletë votimi përkatësisht një fletë votimi për kryetarin e bashkisë dhe fleta tjetër e votimit për këshillin e bashkisë.

Në çdo qendër votimi janë dy kuti votimi.

ORGANET DHE ADMINISTRATA ZGJEDHORE PËR ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE



KQZ është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve

KZAZ përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në zonën e administrimit zgjedhor

KQV përgjigjet për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit

GNV nxjerrin rezultatin e zgjedhjeve për çdo QV të zonës së administrimit zgjedhor



ÇFARË ËSHTË KZAZ?

KZAZ është komisioni që funksionon si organ kolegjal dhe që krijohet për zgjedhjet me vendim të KShZ. Afati ligjor për krijimin e tyre është jo më vonë se 90 ditë para datës së zgjedhjeve. KZAZ mbulon si rregull një zonë të administrimit zgjedhor. Zonat e administrimit zgjedhor krijohen nga KQZ të cilat funksionojnë për çdo lloj zgjedhjeje. Zona e Administrimit zgjedhor është e njëjtë me territorin administrativ të një bashkie. Ky është rregulli i përgjithshëm. Por, në rastet kur bashkia ka më shumë se 80 mijë shtetas me të drejtë vote, KQZ krijon më shumë se një zonë të administrimit zgjedhor në këtë bashki, sipas disa kritereve, të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Për Bashkinë e Tiranës secila nga njësitë administrative, ish-njësi bashkiake përbëjnë një zonë administrimi zgjedhor më vete.

KZAZ përmbush funksionet në përputhje me dispozitat e Kodit zgjedhor dhe aktet e nxjerra nga KQZ si dhe përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në zonën e administrimit zgjedhor që mbulon. Veprimtaria e KZAZ bazohet në parimet e ligjshmërisë, kolegjalitetit, profesionalizmit, pavarësisë, paanësisë dhe transparencës.

Detyrat dhe veprimtaritë, KZAZ i ushtron në selinë e saj e cila evidentohet përmes vendosjes së tabelës treguese me numrin e KZAZ, emrat e anëtarëve, orarin e punës, numrin e telefonit si dhe adresën e postës elektronike. Në çdo seli të KZAZ, në një vend të dukshëm, vendoset flamuri kombëtar. Çdo anëtar i KZAZ mban, në mënyrë të dukshme, dokumentin e identifikimit të funksionit që ka.

PËRBËRJA DHE ORGANIZIMI I KZAZ

Çdo KZAZ përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari. Në përbërjen e KZAZ synohet të arrihet një lloj balancimi politik. Partitë politike, përkatësisht partia kryesore e shumicës parlamentare si dhe partia kryesore e opozitës parlamentare kanë të drejtë të propozojnë në KQZ, nga dy anëtarë secila. Të drejtën e propozimit për anëtarë në KZAZ e ka edhe partia e dytë e shumicës parlamentare si dhe partia e dytë e opozitës parlamentare. Secila prej tyre ka të drejtë të propozojë nga një anëtar.

Ndërsa anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër, nga partia e parë e opozitës parlamentare. Është shorti që organizohet në KQZ që përcakton se në cilat KZAZ, anëtari i shtatë do të jetë i partisë kryesore të shumicës parlamentare apo përfaqësues i partisë kryesore të opozitës parlamentare.

Çdo KZAZ, në mbledhjen e parë, e cila thirret me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, propozon kryetarin dhe zëvendëskryetarin. Mbledhja e parë e KZAZ-së drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

Për të përcaktuar se cilit subjekt zgjedhor i përket kryetari apo zëvendëskryetari, Kodi Zgjedhor ka parashikuar se në KZAZ-të ku anëtari i shtatë i përket partisë kryesore të shumicës parlamentare, kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KZAZ-së, përfaqësues i partisë kryesore të shumicës parlamentare. Në këto KZAZ, të drejtën e propozimit për kryetarin e ka një nga anëtarët e propozuar nga partia kryesore e shumicës parlamentare. Në gjysmën tjetër të KZAZ-ve, kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët e KZAZ-së, përfaqësues i partisë kryesore të opozitës parlamentare. Në këto KZAZ, të drejtën e propozimit për kryetarin e ka një nga anëtarët e propozuar nga partia kryesore e opozitës parlamentare. Zëvendëskryetari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin. Të drejtën e propozimit për zëvendëskryetarin e ka njëri nga anëtarët e propozuar nga partia politike që i përket zëvendëskryetari. Propozimet paraqiten me shkrim dhe firmosen nga anëtarët e KZAZ që mbështesin propozimin. KZAZ merr vendim për emërimin e kryetarit e të zëvendëskryetarit dhe të gjithë anëtarët e KZAZ votojnë pro propozimit. Format i këtij vendimi është i miratuar nga KShZ dhe KZAZ e ka pjesë të dokumentacionit të saj të punës me emërtimin: vendim "Për propozimin e kryetarit të KZAZ" dhe vendim "Për propozimin e zëvendëskryetarit të KZAZ". Një kopje e vendimit dërgohet në KQZ.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve emëron kryetarin dhe zëvendëskryetarin, me propozim të KZAZ.

Anëtari i emëruar kryesisht për plotësim të vakancës nuk mund të propozohet e të emërohet kryetar apo zëvendëskryetar i KZAZ.

Anëtarët dhe sekretari i KZAZ duhet të zbatojë me përpikmëri Kodin Zgjedhor, aktet e KQZ dhe vendimet e marra prej KZAZ. Detyrat e detajuara të KZAZ, anëtarit apo sekretarit të saj janë të përcaktuara në një rregullore të miratuar me vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 nga Komisioni Rregullator.



EMËRIMI I ANËTARIT DHE SEKRETARIT TË KZAZ

Anëtarët dhe sekretari KZAZ emërohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KShZ).

Anëtar dhe sekretar i KZAZ-së mund të emërohet çdo person që plotëson disa kushte. Së pari ky individ duhet të gëzojë të drejtën për të qenë zgjedhës e të ketë arsimin e lartë. Specifikisht sekretari i KZAZ duhet të jetë me profesion jurist. Gjithashtu, anëtarët e sekretari i KZAZ duhet të jetë me vendbanim në zonën përkatëse zgjedhore si dhe nuk duhet që të jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Nuk mund të emërohet si anëtar apo sekretar i KZAZ, një individ ndaj të cilit është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së nuk mund të jetë deputet, kandidat për deputet në Kuvend, kryetar bashkie, ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror apo anëtar, sekretar i një komisioni tjetër zgjedhor.

SHKARKIMI DHE LIRIMI NGA DETYRA I ANËTARIT TË KZAZ

Në rast të mospërbushjes së detyrimeve apo kur shkelin dispozitat që burojnë nga Kodi Zgjedhor apo aktet e nxjerra në zbatim të tij, Kodi Zgjedhor ka parashikuar mundësinë e shkarkimit të anëtarit apo sekretarit të KZAZ. Anëtari apo sekretari i KZAZ shkarkohet nëse dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo në rastet e mosrespektimit të disiplinës dhe mungesës së përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrës. Kodi Zgjedhor ka parashikuar se shkarkohet anëtari apo sekretari i KZAZ kur mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZAZ, ose kur, në periudhën zgjedhore, nuk paraqiten në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme, për më shumë se 2 ditë rresht.

Një shkak tjetër i rëndësishëm që sjell shkarkimin e anëtarit apo sekretarit të KZAZ është edhe mospjesëmarrja e tyre në trajnimet e organizuara nga KQZ apo kur nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja. Pjesëmarrja në trajnimet dhe testimet e organizuara nga KQZ është detyrim ligjor dhe si i tillë duhet përmbushur nga ana e anëtarëve e sekretarit të KZAZ. Rëndësia e trajnimeve është prioritet, pasi performanca e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ lidhet drejtpërsëdrejti në cilësinë e organizimit të zgjedhjeve dhe rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj zgjedhjeve, të cilat çojnë në legjitimitetin e tyre.

Anëtarët dhe sekretari i KZAZ shkarkohen me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore. Kërkesa paraqitet me shkrim dhe duhet të jetë e argumentuar për shkeljen e pretenduar. Edhe anëtari apo sekretari i KZAZ njofton KShZ me shkrim dhe të argumentuar, nëse evidenton një nga kushtet që sjellin shkarkimin e anëtarit apo sekretarit të KZAZ.

Përveç shkarkimit, Kodi Zgjedhor ka parashikuar edhe mundësinë e lirimit nga detyra të anëtarit apo sekretarit të KZAZ. Anëtarët dhe sekretari KZAZ lirohen nga detyra kur kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë apo kur janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumëpartiake të një partie apo koalicioni që konkurron në zonë. Shkak për lirimin nga detyra të anëtarit apo sekretarit të KZAZ është edhe kur ata nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës apo nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore.

Lirimi nga detyra bëhet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Çdo anëtar apo sekretari i KZAZ njofton KShZ me shkrim dhe të argumentuar, nëse evidenton një nga kushtet që sjellin lirimin e anëtarit apo sekretarit të KZAZ.

Një rast tjetër i lirimit nga detyra është kur subjekti zgjedhor, që ka propozuar anëtarin apo sekretarin e KZAZ, kërkon zëvendësimin e tyre. Në këtë rast, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve merr vendimin e lirimit nga detyra të anëtarit apo sekretarit të KZAZ.

VAKANCAT NË KZAZ

Anëtari apo sekretari i KZAZ mund të japë dorëheqjen nëpërmjet deklaratës së dorëheqjes që depozitohet në KZAZ. Në një rrethanë të tillë, KZAZ ndodhet në kushtet e vakancës. Për të mundësuar zëvendësimin, duhet që KZAZ, përmes sekretarit të saj, të njoftojë, menjëherë me shkrim, KQZ si dhe përfaqësuesin e partisë politike përkatëse, anëtari i së cilës ka sjellë vakancën. Njoftimit me shkrim i bashkëngjitet detyrimisht kopja e deklaratës së dorëheqjes.

Anëtari që është në kushtet e konfliktit të interesit e vetëdeklaron vetë atë, me shkrim, por këtë mund ta bëjë edhe çdo anëtar tjetër që ka dijeni. Deklarata administrohet dhe sekretari njofton KShZ.

Vakanca krijohet edhe kur anëtari apo sekretari i KZAZ shkarkohet apo lirohet nga detyra.

Në të gjitha këto rrethana është shumë e rëndësishme të zbatohet se askush prej tyre nuk mund të largohet pa dorëzuar detyrën tek anëtari që do ta zëvendësojë.

MBLEDHJET E KZAZ

Mbledhjet e KZAZ janë publike. Që një mbledhje e KZAZ të konsiderohet e vlefshme duhet që të plotësohet kuorumi, pra në të, të marrin pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të KZAZ-së. Kuorumi përbëhet nga të paktën katër anëtarë të KZAZ.

Mbledhjet e KZAZ-së në vijimësi thirren nga Kryetari i KZAZ. Njoftimi për mbledhje bëhet të paktën 24 orë përpara zhvillimit të saj dhe sekretari i KZAZ përgatit materialet e mbledhjeve, njoftimin e anëtarëve dhe afishimin e njoftimit. Kur në mbledhje nuk janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të KZAZ, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një orë tjetër, të paktën dy orë pas të parës. Gjatë zhvillimit të mbledhjeve ndalohen komunikimet me telefon apo forma të tjera të komunikimit me të tretët. Procesverbal i mbledhjeve mbahet nga sekretari në librin e protokollit dhe firmoset nga anëtarët e KZAZ si dhe vuloset me vulën e KZAZ. Votimi në KZAZ është i hapur dhe bëhet me ngritjen e dorës ose me deklaram. Abstenimi nuk lejohet. Çdo anëtar ka të drejtë të shpjegojë votën e tij. Rezultatet e votimit shënohen në Librin e Protokollit. Kur KZAZ nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja dërgohet nga kryetari apo dy anëtarë, brenda 24 orëve, te Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendimi i të cilit është i detyrueshëm për KZAZ. Vota e anëtarëve që janë në kushtet e konfliktit të interesit dhe që nuk janë liruar nga detyra, është e pavlefshme dhe nuk llogaritet në kuorum. Anëtari i KZAZ ka të drejtë të njihet me materialet e mbledhjes, jo më vonë se 2 orë, përpara zhvillimit të mbledhjes. Sekretari ka të drejtë të diskutojë dhe të japë mendimin e tij, si anëtar pa të drejtë vote. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ ka të drejtë të komunikojë me KShZ, përmes administratës së KQZ, për çdo problem që vlerëson të arësyeshëm.

VENDIMET E KZAZ

Vendimet e KZAZ-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote. Vendimet e KZAZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të komisionit, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën "pro" ose "kundër", si dhe arsyetimin përkatës. Vendimet e KZAZ ankimohen nga subjektet zgjedhore, të cilat shqyrtohen dhe zgjidhen në rrugë administrative nga KAS. KAS mund të vendosë masa disiplinore. Masat disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhore vendosen edhe me kërkesë të Komisionerit, në rastet kur pas kontrollit aposteriori të materialit zgjedhor janë konstatuar shkelje ose parregullsi në administrim.

KZAZ ka detyrimin që vendimet e marra t'i bëjë publike dhe një kopje të tyre t'i dërgojë në KQZ.

Anëtarët dhe sekretari i KZAZ duhet të zbatojë me përpikmëri Kodin Zgjedhor, aktet e KQZ dhe vendimet e marra prej KZAZ. Detyrat e detajuara të KZAZ, anëtarit apo sekretarit të saj janë të përcaktuara në një rregullore të miratuar me vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 nga Komisioni Rregullator.



DETYRA TË KZAZ PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË VOTIMIT

KZAZ emëron kryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së.

KZAZ krijon KQV dhe emëron anëtarët e tyre. Është e nevojshme të dihet se të drejtën e propozimit të anëtarëve dhe sekretarit të KQV e kanë subjektet zgjedhore. Afati kohor i propozimeve nga partitë politike është jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve. Mbi bazën e propozimeve të partive politike, KZAZ emëron kryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, të përfshira në juridiksionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor që ajo mbulon.

Çdo KQV përbëhet nga 7 anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit. Edhe në rastin e KQV, Kodi Zgjedhor ka synuar arritjen e një barazpeshimi politik. Partia kryesore e shumicës parlamentare propozon dy anëtarë dhe dy anëtarë të tjerë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare. Gjithashtu, ka të drejtë të propozojë një Anëtar, partia e dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar tjetër propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare.

Anëtari i shtatë i KQV propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kriterëve objektive të bazuara në përzgjedhjen rastësore apo shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor.

Anëtarët dhe sekretari i KQV-së emërohen vetëm për periudhën e zgjedhjeve. KZAZ-ja emëron anëtarët e KQV-ve jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve. KZAZ i bën emërimet pasi shqyrton dhe konstaton se propozimi është në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor.

Që KZAZ të jetë në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor për emërimin e anëtarëve apo sekretarit të KQV duhet të ketë parasysh rastet e papajtueshmërisë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KQV. Anëtari dhe sekretari i KQV-së nuk mund të jenë deputet ose kandidat për deputet në Kuvend, kandidat ose i zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore, ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose i Shërbimit Informativ Shtetëror ose anëtar apo sekretar i një komisioni tjetër zgjedhor.

KZAZ emëron, në detyrën e anëtarit apo sekretarit të KQV, çdo person që plotëson disa kushte si të drejtën për të qenë zgjedhës, të paktën arsimin e mesëm, me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse, i padënuar dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi si dhe pa masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme. Si rregull, sekretari i KQV ka arsimin e lartë.

Procedura që KZAZ ndjek për të caktuar anëtarin e shtatë

Për të përcaktuar se cilës parti politike i përket anëtari i shtatë i KQV, KZAZ vepron si vijon:

a) Rendit Qendrat e Votimit që ka nën juridiksionin e Zonës së saj të Administrimit. Dihet se çdo qendër votimi ka një numër unik si p.sh. QV 1980/00, QV 1981/00. Qendrat e Votimit renditen sipas numrit të tyre unik në rend rritës. Pra kjo renditje bëhet duke filluar nga Qendra e votimit me numrin unik më të vogël deri te qendra e votimit me numrin unik më të lartë. Duhet patur parasysh se QV që kanë numër unik me fraksion p.sh. 1981/01 renditen menjëherë pas QV të origjinës p.sh. 1979/00, 1980/00, 1981/00, 1981/01, 1982/00.

b) Numërton Qendrat e Votimit. KZAZ pasi ka realizuar renditjen e të gjitha qendrave të votimit sipas numrit unik të tyre, vijon duke numërtuar QV me numra natyrorë duke filluar nga numri 1 (një) e duke vazhduar në rend rritës deri në numërtimin e QV-së së fundit, p.sh.

1. 1979/00
2. 1980/00
3. 1981/00
4. 1981/01
5. 1982/00
6. 1983/00

Në QV që mbajnë numër natyror çift (2, 4, 6), anëtari i shtatë i KQV-së do të propozohet nga partia politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZAZ-së ndërsa në QV-të që mbajnë numër natyror tek (1, 3, 5), anëtari i shtatë i KQV-së do të propozohet nga partia politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së. Sekretari propozohet nga partia politike e cila propozon zëvendëskryetarin e KZAZ dhe duhet të jetë jurist. Sekretari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.

Nga shorti i hedhur në KQZ, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, Partia Socialiste e Shqipërisë do të propozojë anëtarin e shtatë në KZAZ me numër çift, ndërsa në KZAZ me numër tek, anëtari i shtatë do të propozohet nga Partia Demokratike. Kjo do të thotë që në KZAZ me numër çift, kryetari i saj do të jetë i Partisë Socialiste dhe nënkryetari do të jetë i Partisë Demokratike, ndërsa në KZAZ me numër tek, kryetari do të jetë i Partisë Demokratike dhe nënkryetari i Partisë Socialiste.

Pra, në KZAZ me numër çift, ku kryetari i saj është i Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe nënkryetari i Partisë Demokratike, në qendrat e votimit që në renditjen e tyre korrespondojnë me numër natyror çift (2, 4, 6), anëtari i shtatë i KQV do të propozohet nga Partia Socialiste e Shqipërisë, ndërsa në po këtë KZAZ, në qendrat e votimit me numër natyror tek (1,3,5,7,9) anëtari i shtatë i KQV do të propozohet nga Partia Demokratike e Shqipërisë.

Në KZAZ me numër tek, kryetari i saj është i Partisë Demokratike të Shqipërisë, ndërsa nënkryetari është i Partisë Socialiste, atëherë, në qendrat e votimit me numër natyror çift (2, 4, 6, 8), anëtari i shtatë i KQV do të propozohet nga Partia Demokratike e Shqipërisë, ndërsa në po këtë KZAZ, në qendrat e votimit me numër natyror tek (1,3,5,7,9) anëtari i shtatë i KQV do të propozohet nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Kjo procedurë kryhet jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve. Pasi KZAZ kryen procedurën e mësipërme për të përcaktuar se cilës parti politike i përket anëtari i shtatë i KQV, ajo menjëherë, njofton partitë politike përkatëse për paraqitjen e propozimeve për anëtarin e shtatë të KQV-ve.

KZAZ shkarkon dhe liron nga detyra anëtarin apo sekretarin e KQV

Anëtari apo sekretari i KQV shkarkohen nga detyra me vendim të KZAZ.

Në rast të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor apo akteve të dala në zbatim të tij, Kodi Zgjedhor ka parashikuar shkarkimin e anëtarit apo sekretarit të KQV.

Po kështu, anëtari a sekretari i KQV shkarkohet nëse dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo në rast se nuk paraqiten në detyrë, pa shkaqe të arësyeshme për më shumë se dy ditë rresht. Kjo ndodh edhe nëse anëtari apo sekretari i KQV nuk merr pjesë në trajnimet e organizuara nga KQV. Anëtari dhe sekretari i KQV-së i shkarkuar nga detyra me vendim të KZAZ-së, nuk mund të rizgjidhet në këtë detyrë.

Kodi zgjedhor parashikon edhe rastet e lirimt nga detyra të anëtarit apo sekretarit të KQV. Anëtari apo sekretari i KQV lirohen nga detyra me vendim të KZAZ.

Anëtarët dhe sekretari KQV lirohen nga detyra kur kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë apo kur janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve që konkurron në zonë. Shkak për lirim nga detyra të anëtarit apo sekretarit të KQV është edhe kur ata nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës apo japin dorëheqje. Anëtari apo sekretari i KQV mund të japë dorëheqjen nëpërmjet kërkesës me shkrim për dorëheqje që depozitohet në KQV. Është shumë e rëndësishme të dihet që kushdo që jep dorëheqjen nuk mund të largohet pa dorëzuar detyrën tek anëtari që do ta zëvendësojë. Për të mundësuar zëvendësimin duhet që KQV, përmes sekretarit të saj, të njoftojë menjëherë KZAZ si dhe degën lokale të partisë politike përkatëse, anëtari i së cilës ka dhënë dorëheqjen.

KZAZ ndjek procedurat për plotësimin e vakancave në KQV

Për çdo vakancë të krijuar në KQV, si fillim KZAZ njofton degën lokale të partisë politike përkatëse për të paraqitur propozimin e ri. Zëvendësimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së bëhet, si rregull, me persona, të cilët kanë trajnim për legjislacionin zgjedhor. Anëtari i ri duhet të emërohet nga KZAZ brenda 3 (tri) ditëve nga data e krijimit të vendit të lirë, por jo më vonë se 24 orë para hapjes së procesit të votimit, ndërsa zëvendësimi i anëtarëve të larguar në ditën e zgjedhjeve ose që nuk paraqiten në detyrë në ditën e zgjedhjeve, bëhet jo më vonë se 2 orë nga njoftimi i mungesës. KZAZ plotëson vakancat kryesisht kur përmbushen dy kritere:

Nëse afati nuk respektohet nga partia politike që duhet të bëjë propozimin dhe KQV është në kushtet e mungesës së kuorumit. KZAZ urdhëron KQV të vazhdojë procedurat edhe në kushtet e mungesës së kuorumit të KQV. KZAZ deri në plotësimin e kuorumit në KQV përkatëse, emëron shtetas të përzgjedhur nga lista me emrat të miratuar nga KQZ për emërimet kryesisht.

DETYRA TË KZAZ PËR AKREDITIMIN E VËZHguesVE

KZAZ akrediton vëzhgues të subjekteve zgjedhore

Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ka parashikuar të drejtën e partive politike për të caktuar nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave vetëm pasi kjo parti politike të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ. Të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka subjekti zgjedhor që ka regjistruar listë shumemërore, sipas rastit në KQZ/KZAZ. Të drejtën për të caktuar vëzhgues e kanë edhe partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje si koalicion, por në këtë rast të drejtën për të caktuar vëzhgues, e ka vetëm koalicioni. Çdo koalicion mund të caktojë jo më shumë se tre vëzhgues. Sa i përket kandidatëve të subjekteve zgjedhore, ata nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe në VNV në zonën zgjedhore përkatëse.

Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore duhet të akreditohen. Si rregull akreditimin e vëzhguesve e kryen KQZ, por akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, KQZ mund ta delegojë te KZAZ.

Dy janë kriteret për të qenë vëzhgues i propozuar nga subjektet zgjedhore. Së pari vëzhguesi duhet të gëzojë të drejtën për të qenë zgjedhës dhe së dyti nuk duhet të jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Procedura për akreditimin e vëzhguesve

Lidhur me procedurën që ndiqet në akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore nga KZAZ, ndiqen disa hapa:

Së pari, subjekti zgjedhor, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së zgjedhjeve, dorëzon pranë KZAZ përkatëse, kërkesën për akreditimin e vëzhguesve të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar nga partia politike, partia udhëheqëse e koalicionit apo kandidati i propozuar nga zgjedhësit. Akti i autorizimit depozitohet në KZAZ-në përkatëse; Vërtetimin që është regjistruar si subjekt zgjedhor dhe ka regjistruar kandidatë në zgjedhje; Listën e vëzhguesve, që kërkohet të akreditohen pranë KZAZ-së/KQV-së/VNV-së përkatëse. Lista duhet të jetë e nënshkruar në çdo faqe nga kryetari i partisë politike ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, i partisë udhëheqëse të koalicionit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, apo nga kandidati i propozuar nga zgjedhësit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Lista dorëzohet sipas modelit përkatës miratuar nga KQZ; vetdeklarimin e vëzhguesit për gjendjen gjyqësore.

Verifikimi i dokumentacionit dhe vendimmarrja e KZAZ

KZAZ-ja verifikon dokumentacionin e dorëzuar për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi, brenda 2 (dy) ditëve nga paraqitja.

Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacionin e paraqitur, në përmbajtje ose në formë, KZAZ ia kthen për plotësim/korrigjim subjektit zgjedhor përkatës. Dokumentacioni i plotësuar/korrigjuar ridepozitohet pranë KZAZ-së, brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga shpallja e vendimit të kthimit. Verifikimi i dokumentacionit të plotësuar/korrigjuar kryhet nga KZAZ-ja, brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga ridepozitimi i tij. KZAZ, sipas rastit, miraton ose refuzon kërkesën e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga paraqitja e tyre. Pas marrjes së vendimit për akreditim, KQZ pajis vëzhguesit me autorizimin e akreditimit. Modelet e autorizimeve janë miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Kundër vendimit të KZAZ-së për refuzimin e kërkesës për akreditim mund të bëhet ankim administrativ pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e vendimit.

Vëzhguesit e miratuar me vendim nga KZAZ-ja përkatëse, regjistrohen nga Sekretari i KZAZ-së, në Librin e Protokollit të KZAZ-së dhe në regjistrin e vendimeve si dhe pajisen nga ai me autorizimin përkatës, sipas modelit të përcaktuar nga KQZ. Vëzhguesit mund të kryejnë vëzhgime vetëm në ambientet zgjedhore të përcaktuar në autorizimin e KZAZ-së.

Autorizimi firmoset nga kryetari dhe zv.Kryetari i KZAZ-së, dhe vuloset me vulën e KZAZ-së. Në autorizimin e lëshuar duhet të përcaktohet: Zona zgjedhore (qarku ose bashkia), numri i KZAZ, emri, mbiemri i vëzhguesit, emri i subjektit zgjedhor që e cakton si vëzhgues dhe zona ku do të vëzhgojë (KZAZ/QV/VNV).

Sekretari i KZAZ-së jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të autorizimit për akreditimin e vëzhguesve dorëzon në KQZ në formë elektronike listën e vëzhguesve të akredituar si dhe kopje të vendimmarrjeve të KZAZ-së për akreditimin e tyre. Në përfundim të procesit zgjedhor KZAZ dorëzon në KQZ vendimmarrjet për akreditimin e vëzhguesve shoqëruar me listën përkatëse.

Në rast se kompetenca e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore i është deleguar KZAZ-ve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kryesisht ose me kërkesë së subjekteve zgjedhore revokon vendimet e akreditimit të vëzhguesve të lëshuar nga KZAZ-të. Akreditimet e vëzhguesve të subjekteve bëhet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ose KZAZ sipas modelit të përcaktuar nga Komisioneri në vendimin e revokimit të akreditimit.

Të drejta dhe detyra të vëzhguesve

KZAZ duhet të ketë parasysh të drejtat dhe detyrat që kanë vëzhguesit e akredituar nga vetë KZAZ. Kështu, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë të drejtë të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor; të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë; të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.

Gjithashtu, vëzhguesit kanë si detyrë të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe vendimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe vendimet dhe udhëzimet e KZAZ-së ku janë akredituar. Ata nuk duhet të bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti ose koalicion në ambjentet zgjedhore dhe nuk duhet të mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si propagandë ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit. Vëzhguesit duhet të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit dhe numërimit të votave. Vëzhguesit duhet të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin përkatës, të shoqëruar me dokument identifikimi (pasaportë, kartë identiteti). Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të akredituar në VNV, gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave nga GNV-të janë të detyruar të qëndrojnë në vendin e caktuar për ta nga KZAZ-ja si dhe duhet të respektojnë rregullat e etikës në marrëdhëniet me komisionerët zgjedhor dhe vëzhguesit e tjerë, të mos komentojnë me zë dhe të mos debatojnë lidhur me zhvillimin e procesit të votimit.

Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të cilët janë akredituar në VNV kanë edhe disa të drejta të njoftojë KZAZ-në (njoftimi bëhet me ngritjen e dorës) në rast të konstatimit të pasaktësive ose parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave (gjatë verifikimit të materialeve zgjedhore që gjenden në Kutinë e Materialeve Zgjedhore dhe verifikimit të të dhënave për numrin e fletëve të votimit në kutinë e votimit) sipas nenit 116, të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të cilët janë akredituar në VNV mund të kundërshtojnë (kundërshtimi bëhet me ngritjen e dorës) vlerësimin e votës së bërë nga numëruesi i parë i GNV-së. Këta vëzhgues kanë të drejtë të marrin kopje të tabelës përmbledhëse të rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, tabelave të rezultateve të QV-ve dhe kopje të procesverbaleve të konstatimit.

Vëzhgues të akredituar nga KQZ. Media e akredituar

Përveç vëzhguesve të akredituar nga KZAZ, në zonën zgjedhore, qendra votimi apo VNV mund të paraqiten vëzhgues të akredituar nga KQZ. Këta vëzhgues janë të pajisur me autorizimin e akreditimit nga KQZ, i cili është i vlefshëm vetëm për zonën zgjedhore, qendrën e votimit apo VNV dhe afatin e përcaktuar në autorizim. Sa i përket medias së akredituar, ajo krahas të drejtave dhe detyrave që kanë të gjithë vëzhguesit e tjerë, kanë edhe disa të drejta e detyra të tjera. Kështu, media e akredituar ka të drejtë të përdorë kamera në qendrën e votimit por pa ndërhyrë e penguar procesin e votimit. Në ambientet e qendrës së votimit nuk mund të qëndrojnë më shumë se 15 minuta dhe në çdo rast duhet ta ruajë fshehtësinë e zgjedhësit në procesin e tij të votimit. Në vendin e numërimit të votave, vëzhguesit e medias së akredituar mund të instalojnë kamera apo pajisje të tjera ndihmëse dhe mund të transmetojë ecurinë e procesit të numërimit pa ndërhyrë dhe pa ndikuar në veprimtarinë e KZAZ dhe grupeve të numërimit.



DETYRA SHITESË PËR KZAZ QË MBULON E VETME TERRITORIN E BASHKISË

Dokumentacioni i kandidimit për kandidatin për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe për kandidatët për këshillin vendor depozitohen në KZAZ-në që mbulon njësinë përkatëse të qeverisjes vendore.

Regjistrimi i kandidatit për Kryetar Bashkie i paraqitur nga partia politike/koalicioni

Partia politike ose koalicioni që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, depoziton sipas rastit në KQZ/KZAZ kërkesën për regjistrimin e kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, të nënshkruar nga kryetari i partisë apo koalicionit apo personi i autorizuar prej tyre. Autorizimi i kryetarit të partisë apo koalicionit është pjesë e dokumentacionit. Gjithashtu, në këtë dokumentacion duhet të dorëzohet deklarimi për pranimin e kandidimit, kopje e deklaratës së dorëheqjes nga funksionet të cilat krijojnë papajtueshmëri me kandidimin e cila duhet të jetë prokolluar nga institucioni përkatës. Jetëshkrimi i kandidatit, kopja e dokumentit të identifikimit të kandidatit për Kryetar Bashkie si dhe formulari i vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar Bashkie janë pjesë e dokumentacionit që depozitohet në KZAZ.

Partia politike/koalicioni depoziton edhe vërtetimin për zotërimin e mandatit të paktën 6 muajt e fundit në Kuvend, ose në organet e qeverisjes vendore përkatëse.

Për këtë të fundit, në rast se partia politike nuk zotëron mandat, të paktën 6 muajt e fundit ajo paraqet edhe formularin tip të nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse që mbështesin kandidatin/partinë/koalicionin. Formularin tip i bashkëlidhet fotokopja e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, të nënshkruar nga çdo zgjedhës.

Lista mbështetëse e paraqitur nga partia politike duhet të përmbajë 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore përkatëse, por në çdo rast, jo më shumë se 3000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës, emrat e të cilëve janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë.

Partitë përbërëse të koalicionit duhet të zotërojnë të paktën 6 muajt e fundit një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjestare të koalicionit në Kuvend, ose në organet e qeverisjes vendore përkatëse. Në rast se koalicioni, partitë pjestare të së cilit nuk zotërojnë, të paktën gjashtë muajt e fundit, bashkarisht mandate në Kuvend apo Këshillin e Bashkisë përkatëse, sa numri i kërkuar, ky koalicion paraqet listën e zgjedhësve që mbështesin kandidatin e propozuar prej tij si dhe formularin tip që i bashkëlidhet, fotokopja e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, të nënshkruar nga çdo zgjedhës.

KZAZ përcjell menjëherë në KQZ listën e kandidatëve së bashku me formularët e vetëdeklarimit. Përcjellja e dokumentacionit në KQZ bëhet jo më vonë se 48 orë nga dorëzimi i dokumentacionit në KZAZ.

Regjistrimi i listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtar të këshillit bashkiak të propozuar nga partia politike ose koalicioni

Partia politike ose koalicioni që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, depoziton në KZAZ kërkesën për regjistrimin e listës shumëmemërore për anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Partia politike ose koalicioni për regjistrimin e listës shumëmemërore duhet të paraqesin, sipas rastit në KQZ/KZAZ, kërkesën për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të nënshkruar nga kryetari i partisë ose personi i autorizuar prej tij. Autorizimi i kryetarit të partisë për nënshkrimin e listës shumëmemërore, nëse lista nuk është nënshkruar nga kryetari i partisë është pjesë e dokumentacionit. Pjesë e dokumentacionit është dhe deklarata e secilit prej kandidatëve të listës shumëmemërore për pranimin e kandidimit, kopje e deklaratës së dorëheqjes nga funksionet të cilat krijojnë papajtueshmëri me kandidimin e cila duhet të jetë prokolluar nga institucioni përkatës, vërtetimi i nënshkruar nga Kuvendi ose njësia përkatëse e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit, të paktën 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose organit të njësisë së qeverisjes vendore. Formulari tip i nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse që mbështesin kandidatin/partinë/koalicionin shoqëruar me fotokopjen e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, e nënshkruar nga çdo zgjedhës janë pjesë e dokumentacionit ashtu sikurse jetëshkrimi i kandidatëve të listës shumëmemërore, Kopja e dokumentit të identifikimit të kandidatëve të listës shumëmemërore. Depozitimi i dokumentacionit reflektohet në procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve.

Regjistrimi i kandidatit për kryetar bashkie i propozuar nga zgjedhësit

Për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, komiteti nismëtar regjistrohet në KZAZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës.

Komiteti Nismëtar, që është regjistruar në KQZ/KZAZ për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për të mbështetur një kandidat të propozuar nga zgjedhësit, depoziton sipas rastit në KQZ/KZAZ kërkesën për regjistrimin e kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin përkatës në të cilin përfshihet deklarata e kandidatit për hapjen e llogarisë të posaçme bankare për dhurimin e fondeve jopublike, nëse planifikon të pranojë dhurime për fushatë, deklarata e pranimit të kandidimit, deklarata e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit se nuk është pjesë e asnjë partie apo koalicioni dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë, ndonjë subjekt apo kandidat tjetër. Gjithashtu komiteti nismëtar depoziton edhe kopje të deklaratës së dorëheqjes nga funksionet të cilat krijojnë papajtueshmëri me kandidimin e cila duhet të jetë protokolluar nga institucioni përkatës, vërtetimi i nënshkruar nga Kuvendi ose njësia përkatëse e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit, të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit. Formulari tip i nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse emrat e të cilëve janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të zonës zgjedhore përkatëse, shoqëruar me fotokopjen e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, e nënshkruar nga çdo zgjedhës janë pjesë e dokumentacionit ashtu sikurse jetëshkrimi i kandidatit, Kopja e dokumentit të identifikimit të kandidatit. Formulari i vetëdeklarimit të kandidatit është një tjetër dokument i depozituar. Depozitimi i dokumentacionit reflektohet në procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve.

Regjistrimi i kandidatit për anëtar të këshillit bashkiak të propozuar nga zgjedhësit

Komiteti Nismëtar, që është regjistruar në KQZ/KZAZ për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për të mbështetur një kandidat të propozuar nga zgjedhësit, depoziton, sipas rastit, në KQZ/KZAZ kërkesën për regjistrimin e kandidatit për anëtar të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Komiteti Nismëtar duhet të paraqesë, sipas rastit, në KQZ/KZAZ, deklaratën e kandidatit për hapjen e llogarisë të posaçme bankare për dhurimin e fondeve jopublike, deklaratën e pranimit të kandidimit, deklaratën e kandidatit për anëtar të këshillit të qeverisjes vendore të propozuar nga zgjedhësit se nuk është pjesë e asnjë partie apo koalicioni dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë, ndonjë subjekt apo kandidat tjetër. Gjithashtu komiteti nismëtar depoziton edhe kopje të deklaratës së dorëheqjes nga funksionet të cilat krijojnë papajtueshmëri me kandidimin e cila duhet të jetë protokolluar nga institucioni përkatës, formularin me nënshkrimet e zgjedhësve, emrat e të cilëve janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të zonës zgjedhore të cilit i bashkëlidhet fotokopja e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, e nënshkruar nga çdo zgjedhës. Në dokumentacionin që depozitohet përfshihet edhe vërtetimi me shkrim, i nënshkruar nga Kuvendi apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit, jetëshkrimin e kandidatit, kopja e dokumentit të identifikimit të kandidatit, formulari i vetëdeklarimit të kandidatit. Depozitimi i dokumentacionit reflektohet në procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve.

Që KZAZ të përmbushë sa më mirë detyrën në lidhje me regjistrimin e kandidatëve për kryetar të bashkisë apo këshill bashkiak të propozuar nga partitë politike, koalicionet apo komitetet nismëtare ka hartuar disa modele tip ku përfshihen: formular për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati; kërkesë për regjistrimin e Komitetit Nismëtar; kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit; kërkesë për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie propozuar nga parti politike/koalicion; kërkesë për regjistrimin e listës shumëmemërore për anëtarë të këshillit bashkiak propozuar nga parti politike/koalicion; deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme nëse do të përfitojnë fonde publik; deklaratë për pranimin e kandidimit; jetëshkrimi i kandidatit; procesverbal i dorëzimit të dokumentacionit të kandidimit që plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Modelet e kandidimit përmbajnë pjesën sqaruese ku përcaktohet mënyra e plotësimit të tyre. Keshillohet që këto modele të plotësohen në format elektronik e më pas të nënshkruhet nga personi përkatës. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të plotësohen shkronja kapitale dhe të deshifrueshme.

KZAZ verifikon dokumentacionin e kandidimit.

KZAZ kryen verifikimin e dokumentacionit të kandidimit në lidhje me përputhshmërinë e tij me kërkesat e Kodit Zgjedhor sipas kërkesave të neneve 67, 68 dhe 72 të tij. Së pari verifikon nëse subjekti parti politike/koalicion është regjistruar si subjekt zgjedhor apo nëse Komiteti Nismëtar që propozon një kandidat është regjistruar. Gjithashtu KZAZ verifikon nëse plotësohen kriteret/kushtet e përcaktuara në kodin zgjedhor, përfshirë edhe zbatimin e kuotës gjinore si dhe plotësinë e dokumenteve të kandidimit dhe të nënshkrimeve.

Në rast se konstatohet mosplotësimi i kushteve/kritereve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, apo mungojnë dokumente, KZAZ-ja i kërkon menjëherë subjektit zgjedhor të bëjë plotësimin e dokumenteve. KZAZ dorëzon në KQZ një kopje të listës së kandidatëve, së bashku me formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat jo më vonë se 48 orë nga marrja në dorëzim.

KZAZ kryen gjithashtu edhe verifikimin e listës së zgjedhësve që mbështesin kandidatët e partisë/ve politike, koalicionit/eve kandidatin e propozuar nga zgjedhësit, të cilët nuk zotërojnë mandat në Kuvend ose zotërojnë së bashku më pak mandate se numri i partive pjesëtare të koalicionit. KZAZ-ja depoziton një kopje të listës për kandidatët për kryetarë dhe këshillat e njësisë së qeverisjes vendore në KQZ, jo më vonë se 24 orë nga miratimi përfundimtar i listës.

KQZ/KZAZ bën verifikimin e nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët. Fillimisht cakton një seancë publike për verifikimin e nënshkrimeve në të cilën marrin pjesë përfaqësuesit e subjektit zgjedhor ose komitetit nismëtar, dhe/ose përfaqësuesit e subjekteve të tjera zgjedhore.

Administrata e KQZ/KZAZ përzgjedh në mënyrë rastësore, 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve mbështetës dhe verifikon nëse ata janë zgjedhës me vendbanim në bashkinë përkatëse. Numri i nënshkrimeve të rregullta pjesëtohet me numrin që përfaqëson 5% të të gjitha nënshkrimeve të paraqitura. Numri që del nga ky pjesëtim shumëzohet me numrin e nënshkrimeve të paraqitura. Rezultati që del nga këto veprime përfaqëson numrin e nënshkrimeve të rregullta në listën e paraqitur. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve të rregullta është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor.

Formularët e vetëdeklarimit për kandidatët për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të propozuar nga partitë politike/koalicioni/komiteti nismëtar depozitohen në KZAZ që mbulon njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dhe në KQZ për bashkitë e tjera. Në rastet kur depozitimi i dokumentacionit të kandidimit dhe formularëve të vetëdeklarimit bëhet në KZAZ, lista e kandidatëve, së bashku me formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat përcillen në KQZ menjëherë por jo më vonë se 48 orë nga dorëzimi i tyre. Verifikimi i formularit të vetëdeklarimit bëhet në KQZ. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore vendimi për refuzimin e regjistrimit të kandidatit apo vendimi për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e kandidatëve i njoftohet menjëherë KZAZ-së që mbulon njësinë e qeverisjes vendore.

KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe, nëse vëren parregullsi apo mospërbushje të kërkesave të Kodit Zgjedhor ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së zgjedhjeve. Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet jo më vonë se 42 (dyzet e dy) ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së, si rregull, jo më vonë se 24 orë nga ridepozitimi, verifikon dokumentacionin e plotësuar. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve/KZAZ-ja vendos për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit të kandidimit, jo më vonë se 24 orë.

KZAZ duhet të ketë parasysh se emrat në listën shumëmemërore të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumëmemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumëmemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre. Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati. Subjekti zgjedhor nuk mund të ndryshojë renditjen e kandidatëve të listës pas regjistrimit të saj. Në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini.



DETYRA TË KZAZ PËR ORGANIZIMIN E VNV

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton, me vendim, vendndodhjen e VNV-së të çdo ZAZ-je. VNV-ja vihet në dispozicion të KZAZ, jo më vonë se 10 ditë para zgjedhjeve.

Vendi i punës së KZAZ është në të njëjtën sallë ku kryhet procesi i numërimit të votave. KZAZ, menjëherë, me marrjen në dorëzim të VNV-së, organizon dhe përgatit VNV në mënyrë të tillë që të garantohet zhvillimi i qetë, i rregullt dhe në transparencë të plotë i procesit të numërimit të votave, i cili duhet të shihet pa asnjë pengesë nga vetë KZAZ, vëzhguesit, kandidatët apo përfaqësuesit e medias.

KZAZ-ja, organizon dhe sistemon VNV, me pajisjet logjistike të nevojshme të siguruar në bashkëpunim me pushtetin vendor, dhe pajisjet e dërguara nga KQZ, tavolinat e punës e karriget e saj, për ndihmësit teknikë si dhe kompjuter, printer, fotokopje, skaner dhe linjë telefonike. KZAZ duhet të marrë masa për sigurimin e ndriçimit të pandërprerë, për mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave. Ajo merr masa për krijimin e kushteve të përshtatshme, ndjek dhe monitoron procesin e instalimit të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

KZAZ-ja, përgatit VNV duke vendosur për çdo grup numërimi, tavolinë numërimi/tavolina pune me hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procedurave të numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit.

Një VNV nuk mund të ketë më pak se tre dhe më shumë se dhjetë tavolina të numërimit të votave. Hapësira ku vendosen tavolinat e numërimit të jetë e mjaftueshme, duke siguruar vendosjen e tyre në distancë dhe të barazlanguar nga njëra-tjetra si dhe të jenë përballë hapësirës ku qëndrojnë vëzhguesit, kandidatët dhe mediat. Tavolinat duhet të jenë të ndara qartë nga hapësira ku qëndrojnë vëzhguesit e akredituar, kandidatët dhe mediat.

Hapësira në dispozicion të çdo GNV duhet të shmangë çdo mundësi për kontakt fizik të personave të pranishëm në VNV me materialet e votimit si dhe të jetë e mjaftueshme për tavolinën e numërimit, kutinë e votimit dhe/ose kutinë e materialeve të votimit që vendosen pranë saj si dhe e përshtatshme për instalimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin dhe vlerësimin e votave. Për çdo anëtar të GNV duhet të sigurohen karrige.

Hapësira ku do të vendosen kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit që merren në dorëzim nga Komisionet e Qendrave të Votimit, si dhe hapësira ku ato do të vendosen pas numërimit të jenë në të njëjtin mjedis ku kryhet numërimi i votave si dhe të jenë të garantuara nga çdo ndërhyrje e personave të paautorizuar. Hapësira ku do të qëndrojnë vëzhguesit e akredituar të jetë përballë dhe në largësi të vogël nga hapësira ku vendosen tavolinat e numërimit si dhe të jetë në distancë jo më pak se një metër e gjysëm nga monitorët kur përdoret teknologjia mbështetëse për numërimin e votave. Kjo hapësirë duhet të krijojë mundësinë e vëzhguesve për të ndjekur nga afër procesin e numërimit të votave dhe shfaqjen e fletëve të votimit në monitorët e vendosur, për këtë qëllim.

Vendi ku do të afishohen kopje të tabelës së rezultatit të qendrave të votimit, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, kopje të tabelës përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së të caktohet pranë hapësirës ku qëndrojnë vëzhguesit e akredituar në mënyrë që të shikohet pa pengesë prej tyre.

KZAZ vendos shenjën në sipërfaqen e çdo tavoline numërimi, e cila gjatë regjistrimit në kamera evidenton qartësisht numrin e grupit të numërimit dhe numrin e qendrës së votimit që numërohet si dhe kamerat regjistruese të montuara dhe monitorët mbi çdo tavolinë numërimi. KZAZ vendos strukturat ndarëse të hapësirës së vëzhguesve, kandidatëve dhe mediave me hapësirën për numërimin e votave.

Në hyrje të objektit ku është vendosur VNV vendos tabelën identifikuese të VNV-së me numrin përkatës të ZAZ-së si dhe shenja orientuese për drejtimin e lëvizjes në mjediset e brendshme të VNV.

KZAZ, jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve, pasi ka sistemuar e organizuar VNV sipas kriterëve si dhe me pajisjet logjistike, fton për njohje të VNV-së subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve.

KZAZ duhet të kujdeset për teknologjinë mbështetëse të numërimit të votave (kamera regjistruese e monitorë), të instaluar në VNV, për ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të kësaj teknologjie nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave në VNV dhe deri në nxjerrjen e rezultatit të Zonës së Administrimit Zgjedhor. Grupi i Numërimit të Votave është përgjegjës për ekspozimin e çdo flete votimi në kamera. Regjistrimi filmik i procesit ruhet në mënyrë elektronike dhe dorëzohet në KQZ, së bashku me materialet e tjera zgjedhore.

Organi që administron objektin ku është vendosur VNV-ja, bashkëpunon për sigurimin e pajisjeve logjistike dhe pajisjeve me mjete të mbrojtëse kundra zjarrit si dhe ato të ndihmës së shpejtë.

Policia organizon ruajtjen e ambientit të Votimit të Numërimit të Votave prej orës 1800 të ditës së zgjedhjeve deri në momentin kur KZAZ transporton kutitë e votimit dhe të materialeve zgjedhore drejt KQZ.

Punonjësi i Policisë së Shtetit qëndron jashtë ambienteve të Vendit të Numërimit të Votave, sipas caktimit të bërë nga KZAZ.


KZAZ si rregull, jo më vonë se 13 ditë para ditës së votimit, cakton me vendim numrin e grupeve të numërimit të votave, për çdo tavolinë numërimi, vendim që dokumentohet përmes modelit të miratuar me vendimin përkatës të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Numri i tavolinave të numërimit në VNV është në raport me numrin e qendrave të votimit të ZAZ. Caktimi i tavolinave të numërimit është si vijon

Caktimi i tavolinave në raport me numrin e QV-ve								
QV	Deri në 30	31-50	51-80	81-100	101 - 115	116 - 130	131-140	Mbi 140
Tavolina	3	4	5	6	7	8	9	10
GNV	6	8	10	12	14	16	18	20

Për çdo tavolinë numërimi janë dy grupe të numërimit të votave dhe çdo grup numëron jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 qendra votimi. Në funksion të procesit të numërimit, funksionojnë edhe grupe të dyta të numërimit të votave të cilat angazhohen me vendim të KZAZ, kur grupet e para përfundojnë punën apo e ndërpresin atë për shkaqe të papërligjura. Nëse nuk është e nevojshme, grupet e dyta të numërimit nuk futen në punë.

Pasi ka përcaktuar numrin e grupeve të numërimit të votave, KZAZ numërton këto grupe me numër rendor rritës. Numri i fundit rendor është gjithmonë një numër çift. KZAZ numërton edhe tavolinat e numërimit të votave, në rend rritës.

Skema organizative e funksionimit të VNV-së





DETYRA TË KZAZ PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

KZAZ emëron me vendim anëtarët e GNV.

Të drejtën e propozimit për anëtarë të grupeve të numërimit të votave e kanë partitë politike, prandaj KZAZ u kërkon, me shkrim, partive politike, të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve, të paktën 12 ditë para datës së zgjedhjeve, të dorëzojnë propozimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve. Propozimet, për anëtarë të GNV, i paraqiten KZAZ-së edhe nga degët lokale të partive politike, kur partitë politike ua kanë deleguar të drejtën e propozimit.

Anëtarët e GNV emërohen nga KZAZ. Çdo GNV përbëhet nga 4 anëtarë, ku një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike së cilës i përket kryetari i KZAZ dhe një anëtar tjetër pas propozimit të partisë politike së cilës i përket nënkryetari i KZAZ. Përcaktimi se cilës parti i takon e drejta e propozimit për anëtarin e tretë apo të katërt bëhet me vendim të KShZ.

Në vendimin për emërimin e grupit të numërimit të votave, KZAZ cakton një nga anëtarët si numërues të parë dhe një anëtar si sekretar sipas kësaj procedure: partia politike e cila ka propozuar nënkryetarin e KZAZ ka të drejtë të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve "tek" të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve "çift", ndërsa partia politike e cila ka propozuar kryetarin e KZAZ ka të drejtë të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve "çift" të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve "tek".

KZAZ, jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve, emëron anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave, veprim që dokumentohet përmes modelit Tip "Për emërimin e anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave", miratuar me Vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në rast se, një parti politike nuk paraqet propozim të paktën 12 ditë nga data e zgjedhjeve, KZAZ me vendim cakton anëtarët zëvendësues. Anëtarët zëvendësues caktohet me short ndërmjet anëtarëve të KQV-ve që i përkasin të njëjtës parti politike në Zonën e Administrimit Zgjedhor. Anëtarët e KQV-ve, të përzgjedhur nga sekretari i KZAZ, renditen, në mënyrë rastësore, në lista, sipas partive politike të cilat i kanë propozuar. Çdo emri të renditur i vendoset një numër rendor rritës duke filluar nga 01. Vendosen shirita letre në një enë transparente, ku janë shënuar numrat rendorë që i korrespondojnë çdo anëtar të KQV-së të partisë politike përkatëse të renditur në listë, të cilat tërhiqen nga kryetari i KZAZ, aq sa është numri i anëtarëve që mungojnë. Anëtarin e KQV-së, i emëruar me propozim të partisë politike, për të cilën hidhet shorti, të cilit i korrespondon numri rendor i shënuar në shiritin e letrës së tërhequr, caktohet anëtar i Grupit të Numërimit të Votave.

Partitë politike, të cilat kanë të drejtën të paraqesin propozimin për anëtarin e tretë ose të katërt të GNV, dhe nuk kanë anëtarë në KQV, humbasin të drejtën të paraqesin anëtar të GNV, nëse nuk propozojnë anëtarin të paktën 12 ditë nga data e zgjedhjeve.

Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave, ai funksionon me jo më pak se dy anëtarë.

Në emërimin e anëtarëve të grupeve të numërimit KZAZ duhet të verifikojë papajtueshmërinë me këtë detyrë. Duhet të kihet parasysh se anëtarin e GNV nuk mund të jetë deputet ose kandidat për deputet në Kuvend, kryetar i njësisë së qeverisjes vendore, ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose i Shërbimit Informativ Shtetëror apo anëtar a sekretar i një komisioni tjetër zgjedhor.

KZAZ emëron në detyrën e anëtarit të GNV personin që plotëson disa kushte si të drejtën për të qenë zgjedhës, të jetë me arsim të lartë dhe në rastin e sekretarit të jetë jurist. Anëtarin e GNV duhet të jetë me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse dhe të jetë i padënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Ndaj tij nuk duhet të ketë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

KZAZ garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit.

KZAZ pajiset me materiale e dokumentacion zgjedhor nga KQZ. Një pjesë e këtyre materialeve e dokumentacioni zgjedhor janë në funksion të veprimtarisë së KZAZ, një pjesë tjetër janë materiale dhe dokumentacion zgjedhor në funksion të veprimtarisë së KQV dhe një pjesë tjetër janë materiale dhe dokumentacion zgjedhor për GNV.

KQZ, me qëllim lehtësimin e punës së KZAZ, përgatit modele tip të gatshme vendimesh apo procesverbalesh e tabelash të cilat KZAZ i përdor në funksion të përmbushjes së detyrimeve të saj, sipas çështjeve që trajton. Kështu, KZAZ ka në dispozicion të saj modelet e vendimeve për :



propozimin e kryetarit të KZAZ; propozimin e zëvendëskryetarit të KZAZ; emërimin e anëtarëve të KQV; emërimin e kryetarit dhe sekretarit të KQV; lirimin e anëtarit/sekretarit të KQV; shkarkimin e anëtarit/sekretarit të KQV; emërimin e anëtarit/sekretarit të KQV për shkak të vakancës së krijuar; caktimin e grupeve të numërimit; emërimin e anëtarëve të grupit të numërimit të votave; caktimin e qendrës së votimit ku do të votojnë anëtarët dhe sekretari i KZAZ, shkarkimin e anëtarit/ve të GNV; caktimin e grupit të numërimit të votave që do të numërojnë dhe vlerësojnë votat e hedhura në kutitë e votimit për secilin organ.; njoftimin e policisë së shtetit për vendosjen e rendit në vendin e numërimit të votave; largimin e policisë së shtetit nga vendi i numërimit të votave.

KQZ ka përgatitur edhe një set modelesh të vendimeve që KZAZ merr për shqyrtimin e kërkesave në kuadër të kandidimit. Ky set modelesh përbëhet nga:

Vendimi për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e komitetit nismëtar; Vendimi për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për kryetar njësisë së qeverisjes vendore; Vendimi për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për këshillin vendor; Vendimi për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar njësisë së qeverisjes vendore të propozuar nga subjekti zgjedhor/koalicioni; Vendimi për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listës së kandidatëve për këshillat vendorë propozuar nga subjekti zgjedhor/koalicioni.

Në dokumentacionin e punës përfshihen edhe libri i protokollit të mbledhjeve, regjistri i vendimeve, regjistri i korrespondencës si dhe procesverbali i konstatimit.

Ka gjithashtu 3 modele të vërtetimeve që KZAZ lëshon të cilat janë: vërtetim për zgjedhësin emri i të cilit nuk gjendet në listën përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor; vërtetim për zgjedhësin emri i të cilit që gjendet në listën përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor; vërtetim i posaçëm për votimin e anëtarit/sekretarit të KZAZ-së.

Modelet e procesverbaleve që plotësohen nga KZAZ janë procesverbali për vulosjen e kutisë së posaçme për fletët e hedhura gabim në kutinë e votimit për kryetar të bashkisë; për vulosjen e kutisë së posaçme për fletët e votimit të hedhura gabim në kutinë e votimit për këshillin e bashkisë; për mbylljen e kutisë së posaçme me fletët e votimit të hedhura gabim për kryetarin e bashkisë; për mbylljen e kutisë së posaçme me fletët e votimit të hedhura gabim për këshillin e bashkisë.

KQZ ka përgatitur procesverbale për administrimin e materialeve zgjedhore. Bëhet fjalë për ato procesverbale të cilat reflektojnë marrjen nga dorëzim nga KZAZ të dokumentacionit e materialeve zgjedhore të dërguara nga KQZ, si dhe procesverbale të cilat lidhen me dorëzimin nga KZAZ të dokumentacionit e materialeve zgjedhore tek KQV, të cilat i rimerr sërish në përfundim të procesit të votimit. Para, ky set procesverbalesh ka të bëjë me hyrje-daljen e dokumentacionit e materialeve zgjedhore. Të tilla procesverbale në emërtim kanë të përdorur termin "për dorëzimin..." apo "Për pajisjen...". Psh procesverbal për pajisjen e KZAZ me materiale për administrimin e zgjedhjeve, për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për procesin e numërimit të votave, për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për KQV-të e ZAZ-së, për pajisjen e KQV nga KZAZ me vula me kode të sigurisë, për dorëzimin në KZAZ të materialeve të votimit, kutisë së votimit me fletët e votimit dhe kutisë së materialeve të votimit nga KQV, për dorëzimin nga KZAZ në KQZ të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhor etj.

Nuk është e nevojshme të mbani mend përmendësh sesa kopje procesverbalesh duhet të plotësohen apo se kujt i jepen këto procesverbale, pasi në përmbajtjen e procesverbalit, KQZ është kujdesur që në secilin prej tyre të shënojë numrin e kopjeve dhe se kujt mund t'i jepet ai procesverbal.

KZAZ merr nga KQZ jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve, materiale e dokumentacion zgjedhor për KQV të cilat janë të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi.

Materialet që KZAZ merr nga KQZ për çdo qendër votimi janë:

Fletët e votimit. Numri i fletëve të votimit është në përputhje me numrin e zgjedhësve të regjistruar në atë qendër votimi, së bashku me fletët shtesë. Si rregull fletët dorëzohen të ambalazhuara në blloqe prej 100 fletësh, së bashku me dokumentin që tregon serinë përkatëse të bllokut të fletëve; Vulën e KQV-së; Procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë edhe formularët tip të procesverbaleve dhe të vendimeve për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, kërkimin e ndihmës së policisë dhe të largimit të saj, si dhe mbylljen e votimit; Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së; zarfet përkatëse për "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA", "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA", "ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES"; Lëndën e posaçme për timbrimin e zgjedhësit dhe aparatit verifikues të saj.

Gjithashtu KZAZ pajiset nga KQZ edhe me materiale të tjera zgjedhore ku përfshihen kuti votimi për çdo qendër votimi, numër i mjaftueshëm kodesh sigurie, sipas vendimit të KQZ-së, numër i mjaftueshëm dhomash të fshehta, kopje të mjaftueshme të Kodit Zgjedhor dhe të materialeve ndihmëse, numrin e nevojshëm të vulave të kryetarëve të KQV-ve dhe mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit. KQZ-ja u dorëzon KZAZ-ve vulat e paketuara, të mbyllura në ambalazhin e sigurisë dhe pa identifikuar numrin serial të vulës.

Përveç materialeve për KQV-të, KQZ-ja i dërgon KZAZ-së edhe pajisjet dhe materialet teknologjike të dërgohen dhe instalohen sipas procedurave të parashikuara me udhëzim të veçantë të KQZ-së. KZAZ pajiset nga KQZ edhe me materiale e dokumentacion zgjedhor për realizimin e procesit të numërimit dhe në funksion të grupeve të numërimit. Kështu në dokumentacionin që mund të përmendim janë:

procesverbal për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara të QV-së; për dorëzimin në KZAZ të zarfave të mbyllur me "vota të hedhura gabim", për secilin organ; për mbylljen e kutisë së materialeve zgjedhore të QV nga GNV; për mungesën e procesverbalit të mbylljes së votimit ose mangësi në plotësimin e tij; tabela të rezultateve të cilat plotësohen nga GNV për çdo qendër votimi.

Shpërndarja e materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV

KZAZ-ja, jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit, u shpërndan materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj. Duke qenë se KZAZ ka në juridiksionin e saj një numër të konsiderueshëm qendra votimit dhe se ato janë në largësi të ndryshme nga selia e saj, KZAZ njofton çdo KQV për kohën e marrjes së materialeve zgjedhore, duke patur parasysh largësinë e saj nga vendndodhja e KZAZ-së. Për të munduruar ardhjen e KQV, KZAZ masat për sigurimin e automjeteve për transportimin e materialeve zgjedhore për çdo KQV. Kryetari dhe sekretari i KQV-së, të shoqëruar nga çdo anëtar tjetër që kërkon, paraqiten në selinë e KZAZ-së dhe tërheqin kutinë me materialet zgjedhore, kutitë e votimit, listën e zgjedhësve, dhomat e fshehta dhe mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

Një procedurë e veçantë është ajo e dorëzimit të vulës së kryetarit të KQV. Kryetari i KQV-së, në praninë e anëtarëve të KZAZ-së, merr në dorëzim vulën e kryetarit të KQV-së sipas veprimeve të mëposhtme: merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave. Vulos, në letër të bardhë për të bërë modelin e krahasimit të vulës dhe shënon emrin dhe mbiemrin e tij, si dhe nënshkruan nën modelin krahasues të vulës. Anëtarët e KZAZ-së nënshkruajnë në pjesën e pasme të letrës së bardhë me modelin krahasues (specimenin) e Vulës së Kryetarit të KQV-së dhe mbahet në ruajtje nga Sekretari i KZAZ-së në një dosjen përkatëse të QV.

KZAZ MERR NË DORËZIM NGA KQV-TË MATERIALET E VOTIMIT DHE KUTITË E VOTIMIT.

KZAZ mbikqyr, drejton dhe kontrollon procesin e marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore nga KQV-ja në KZAZ.

Kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit dërgohen në Vendin e Numërimit të Votave sa më shpejt por jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit në qendrën e votimit. Dërgimi bëhet nga KQV dhe konkretisht nga kryetari dhe sekretari i KQV apo sipas dëshirës edhe ndonjë anëtar i saj, shoqëruar nga punonjësi i policisë së shtetit, i ngarkuar me detyrën e shoqërimit i cili duhet të jetë me uniformën e Policisë së Shtetit dhe me numrin rendor të caktuar nga KQZ-ja dhe mbiemrin e tij me përmasa të dukshme. Dërgimi në KZAZ i kutive të votimit me fletët e votimit dhe i kutisë së materialeve të votimit bëhet me automjetin e siguar për transport nga KZAZ-ja. Materialet e tjera të përdorura gjatë procesit të votimit i dorëzohen KZAZ-së brenda afateve dhe sipas mënyrës së përcaktuar nga KQZ.

KZAZ fillimisht ka përcaktuar vendin e vendosjes së kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutitë me materialet e votimit, para dhe pas numërimit, sipas Planvendosjes Orientuese, si dhe një hapësirë për kutitë e votimit të vlerësuara "kuti e parregullt". Kutitë me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit vendosen sipas numrit të qendrës së votimit, ndërsa qendrat e votimit renditen sipas rendit rritës.

Në rreshtin e parë, në rend rritës, vendos kutinë e votimit për Kryetarin e Bashkisë, në rreshtin e dytë rendit kutinë e votimit për Këshillin e Bashkisë dhe në rreshtin e tretë kutinë me materialet zgjedhore. Në këtë renditje vendosen kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit të çdo QV-je përbri njëra tjetrës.



KZAZ-ja cakton për marrjen në dorëzim të kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë/kutive me materialet zgjedhore një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim. Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga 2 anëtarë të KZAZ-së me përkatësi të ndryshme politike, të propozuar përkatësisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së.

Nëse gjykohet e nevojshme, KZAZ-ja mund të caktojë 2 persona për çdo grup në ndihmë të grupit për marrjen në dorëzim të kutive, të cilët merren kryesisht me sistemin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së. Personeli ndihmës zgjidhet nga lista e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave, duke garantuar në çdo rast baraspeshën politike shumicë-opozitë.

Pajisjet e teknologjisë (PEI dhe Kamera) merren në dorëzim duke plotësuar procesverbalin të emërtuar "Procesverbal për dorëzimin nga KQV në KZAZ të materialeve të votimit". KZAZ ndjek procedurat specifike sipas aktit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri.

Kutitë me fletët e votimit dhe kutia me materialet zgjedhore merren në dorëzim sapo ato mbërrijnë në Vendin e Numërimit të Votave, sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja.

Grupet e marrjes në dorëzim shënojnë në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim numrat e kodeve të sigurisë së vulave, me të cilat është mbyllur kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit si dhe verifikojnë në çast përputhjen e numrave të kodeve të vulave të sigurisë, me të cilat janë mbyllur kutitë me fletët e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, me ato të shënuara në procesverbalin e mbajtur në qendrën e votimit.

Gjithashtu, grupet e marrjes në dorëzim verifikojnë nëse, në kutitë e fletëve të votimit dhe të materialeve zgjedhore, ka hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj, nëse ka thyerje, çarje që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialeve zgjedhore, nëse është e llojit, formës apo përmasave të ndryshme nga ato të miratuara, apo mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie.

Grupi i marrjes në dorëzim, në rast se konstaton mospërputhje të këtyre kodeve apo konstaton se ka hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj, nëse ka thyerje, çarje që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialeve zgjedhore, nëse është e llojit, formës apo përmasave të ndryshme nga ato të miratuara, apo mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie, informon KZAZ-në për mospërputhjen dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet "kuti e parregullt". Anëtarët e KZAZ, verifikojnë parregullsinë e konstatuara. Ata marrin vendim, kur vlerësojnë se kutia është e parregullt, dhe vendosin etiketën "kuti e parregullt" dhe e vendosin atë në këndin e kutive të parregullta.

Në rast se të dy kutitë me fletët e votimit (Kryetar Bashkie/Këshill të Bashkisë) janë vlerësuar "kuti e parregullt", atëherë këto kuti bashkë me kutinë e materialeve të votimit vendosen në këndin e kutive të parregullta. Kutitë e votimit me fletët e votimit e përcaktuar si "Kuti e parregullt", në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapen nga KZAZ dhe nuk i kalojnë GNV për vlerësim. Këto kuti, dërgohen në KQZ, së bashku me kutinë e materialeve të votimit për nevojat e hetimit.

Në rast se vetëm njëra nga kutitë e votimit me fletët e votimit ose ajo për Kryetar Bashkie ose kutia për Këshillin e Bashkisë është vlerësuar "kuti e parregullt", atëherë vetëm kjo kuti dërgohet në këndin e kutive të parregullta, ndërsa kutia tjetër e votimit me fletët e votimit e marrë në dorëzim e rregullt do t'i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe numërimit së bashku me kutinë e materialeve të votimit.

Në rast se kutitë me fletët e votimit janë marrë në dorëzim të rregullta dhe kutia e materialeve të votimit është vlerësuar nga KZAZ si "kuti e parregullt", ajo i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe vlerësimit së bashku me kutitë e votimit me fletët e votimit.

Në çdo rast, parregullsitë që kanë çuar në vlerësimin e kësaj kutie si "kuti e parregullt", shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe në Procesverbalin e Konstatimit. Kopje të Procesverbalit të Konstatimit u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare. Anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari dhe sekretari i KQV-së, si dhe punonjësi i policisë i caktuar për shoqërim nënshkruajnë Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim. Origjinali i Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim administrohet nga KZAZ-ja, e cila u jep nga një kopje përkatësisht kryetarit të KQV-së dhe punonjësit të policisë të caktuar për shoqërimin. Punonjësi i policisë duhet të largohet menjëherë pas marrjes së kopjes së procesverbalit, e cila dorëzohet së bashku me raportin e shërbimit në komandën e strukturës ku ai bën pjesë.

Kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore, të marra në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, vendosen në vendin e përcaktuar paraprakisht nga KZAZ-ja. Ky vend duhet të jetë në të njëjtin mjedis ku kryhet numërimi i votave dhe duhet të jetë i garantuar nga çdo ndërhyrje e personave të paautorizuar.



Kutitë me fletët e votimit të pranuar si të rregullta në çdo rast u nënshtrohen procedurave të hapjes dhe numërimit në Vendin e Numërimit të Votave. Refuzimi për të numëruar sjell shkarkimin e menjëhershëm të personave të ngarkuar për numërimin ose, sipas rastit, KZAZ-së.

Refuzimi për të numëruar kutinë e pranuar si të rregullt përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 330/a të Kodit Penal.

Gjithashtu, anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe nëpunësit e administratës publike në shërbim të këtyre komisioneve mbajnë përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit në fuqi për shkeljen e dispozitave të Kodit Zgjedhor. Anëtarët e komisioneve zgjedhore mbajnë përgjegjësi penale lidhur me falsifikimin e materialit zgjedhor apo rezultateve të zgjedhjeve si dhe për dëmtimin me dashje të materialit zgjedhor. Këto raste janë të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në nenet 326 dhe 326/a të tij.

Shënim

Materiali ndihmës për procesin e numërimit të votave dhe menaxhimin e rezultateve të zgjedhjeve nuk është i përfshirë në këtë material dhe do të trajtohen në materialin për GNV. KZAZ mund të referohet për informacione të detajuara si më poshtë vijon:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Vendim nr. 5, datë 20.11.2020 i Komisionit Rregullator "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor", i ndryshuar

Vendimi nr.11, datë 28.12.2020 i Komisionit Rregullator "Për caktimin e rregullave për administrimin dhe shpërndarjen e vullës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit", i ndryshuar.

Vendimi nr.11, datë 25.03.2021 i Komisionit Rregullator "Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit", i ndryshuar.

Vendimi nr. 12, datë 30.12.2020 i Komisionit Rregullator "Për miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve".

Vendimi nr.3, datë 9.02.2021 i Komisionit Rregullator "Për kriteret e caktimit dhe organizimit të vendit të numërimit të votave".

Vendimi nr.20, datë 18.02.2022 i Komisionit Rregullator "Për kriteret e caktimit të numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave", i ndryshuar

Udhëzimi nr.2, datë 5.12.2020 i Komisionit Rregullator "Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar.

Vendimi nr.32, datë 3.02.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës së Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore".

Vendimi nr.33, datë 3.02.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e modeleve të procesverbaleve të administratës zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore".

Vendimi nr.11, datë 12.01.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor(KZAZ-ve), në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Vendimi nr. 217, datë 01.12.2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Udhëzimi nr.1, datë 18.01.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore".

Vendimi nr.23, datë 1.02.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, Komisionet e Qendrave të Votimit dhe vendet e numërimit të votave në zgjedhje".

Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"